



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës të nivelit “Bachelor “ne Arsim i lartë  
Ushtarak/Policor/Gjeologji/Inxhenjeri Hidroteknike/Mjedisi/Ndertimi/Shkenca  
Ekonomike/Juridike/Pyjore/ Arsimi i Lartë në fushën e Mbrojtjes-Emergjencave Civile.**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar , si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18/03/2015’Për pranimin,Lëvizjen paralele, perjudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM –në nr. 746, datë 19.12.2018, **Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Delvine** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

☐ 2 (dy) ,Specialist Emergjencash Civile,në Zyrën e Emergjencave Civile – kategoria VI-a;

**Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin ne shërbimin civil në kategorinë ekzekutive ) aplikohet në të njëjtën kohë**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për  
LËVIZJE PARALELE:**

**11 QERSHOR 2021**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

Të drejtojnë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashki dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;  
Të grumbullojnë dhe të përpunojnë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;  
Të analizojnë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencës civile në bashki dhe të njoftojnë në qark.  
Të caktojnë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile në territorin e bashkisë.  
Të bashkërendojnë punën për organizimin e sistemit të lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit;  
Të kontribuojnë në parashikimin e burimeve dhe rezervave të nevojshme për sistemin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera;  
Të kontribuojnë në realizimin e organizimit, bashkërendimit dhe pajisjes së forcave operacionale .  
Të ndjekin zbatimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:**

- a) Të zotërojnë diplome të nivelit “Bachelor” në Arsimin e Lartë Ushtarak/Policor/Gjellogji/Inxhenjeri Hidroteknike/Mjedisi/Ndërtimi/Shkenca Ekonomike/Juridike/Pyjore/ Arsimi i Lartë në fushën e Mbrojtjes-Emergjencave Civile.
- b) Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Institucionit Bashkia Delvine dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar;

b-Fotokopje të diplomës së bashku me listën e notave .Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Aplikimi dhe dorëzimi i të gjithave dokumenteve të cituara më sipër të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion pranë protokollit të Bashkisë Delvine , brenda datës 11.06.2021.***

Bashkia Delvine

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Lagjia “Sinan Ballaci “

Rruga “Nazif Haderi “

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën 14.06.2021, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të institucionit dhe skedën e institucionit , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin Nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendor “
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar .
- Njohurite mbi ligjin 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”
- VKM NR.7447, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”
- Njohuri mbi VKM-në nr.835, datë 03.12.2004”Plani Kombëtar për Emergjencat Civile”

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatet do të vleresohen për pervojën , trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën , si dhe çertifikimet pozitive .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

**Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vleresohen në lidhje me :**

- a- Njohuritë , aftësitë , kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës ;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 60 pike.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe stendën e institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

## **2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende ka pozicione vakante , ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë Informacion do ta marrim në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit , në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine dhe stendën e institucionit, duke filluar nga data **14.06.2021**.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Të jete shtetas shqiptarë;
- b) Të jete zotësi për të vepruar ;
- c) Të zotërojnë gjuhën shqipe , të shkruar dhe të folur ;
- d) Të jete në kushte shëndetsore që lejojnë të kryejnë detyrën teknike përkatëse;
- e) Të mos jete i denuar me vendim të formës së prirë për të kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndalim të mos jete marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil , që nuk është shuar

sipas ligjit 152/2013 “Per nepunesin civil “ i ndryshuar .

Kandidati duhet te plotesojne kriteret e veçanta si vijon :

a-Te zoteroje diplome te nivelit

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:**

a) Te zoteroje diplome te nivelit “Bachelor “ne Arsim i lartë Ushtarak/Policor/Gjelogji/Inxhenjeri Hidroteknike/Mjedisi/Ndertimi/Shkenca Ekonomike/Juridike/Pyjore/ Arsimi i Lartë në fushën e Mbrojtjes-Emergjencave Civile.

b)Të ketë paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar .

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash.Për diplomat jashtë Republikës së Shqipërisë të jetë njehsimi pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .

***Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.06.2021*** në adresën

**Bashkia Delvine**

**Lagjia “Sinan Ballaci “**

**Rruga “Nazif Haderi”**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **28.06.2021**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, ne faqen zyrtare te Bashkise Delvine dhe në standën e ndodhur në ambjentet e brendshme të Bashkisë Delvine listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit ne kategoria ekzekutive , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvine , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2.4

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

---

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Njohurite mbi Ligjin Nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendor “
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar .
- Njohurite mbi ligjin 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”
- VKM NR.7447, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”
- Njohuri mbi VKM-në nr.835, datë 03.12.2004”Plani Kombëtar për Emergjencat Civile”

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## 2.5

### MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën , deri në 25 pike.
- c- Jetëshkrimin , që konstiton në vlerësimin e arsimimit të parësorë dhe të trajnimeve , të lidhura me fushën, deri në 15 pike.

## 2.6

### DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stenden e Bashkisë Delvine . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit “ në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine si dhe stendën pranë ambjentëve të brendshme të institucionit :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit të dokumentacionit ,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit “ duke filluar nga data 28.06.2021.